

Prof. Asoc. Dr. Jonida Rystemaj

Propozuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Prof. Asoc. Dr. Jonida Rystemaj është pedagoge e lëndëve “E Drejta e Shoqërive Tregtare” dhe “E Drejta e Biznesit” në Departamentin e së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku ligjëron që prej tetorit 2008. Ajo u diplomua me medalje si studente e shkëlqyer nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2007. Në vitin 2011 përfundoi studimet master në programin “EU Business Law”, financuar nga GIZ, ndërsa në vitin 2013 përfundoi doktoraturën me fokus në instrumentet financiare dhe financimin e korporatave. Në vitin 2024, ajo fitoi titullin akademik Profesor i Asociuar.

Gjatë karrierës së saj, Prof. Asoc. Dr. Rystemaj ka zhvilluar kërkime shkencore në Universitetin e Pittsburgh-ut, SHBA, si përfituese e bursës së akorduar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (janar-maj 2013), si dhe periodikisht në Institutin Max Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private, Hamburg, Gjermani. Përveç angazhimeve akademike, ajo ka kontribuar në kauzat e shoqërisë civile dhe ka ofruar ekspertizë për organizatat e shoqërisë civile, Ministrinë e Drejtësisë dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi çështje si të drejtat e njeriut, arbitrazhi ndërkombëtar, integriteti, lufta kundër korrupsionit dhe integrimi evropian.

Fushat e saj të interesit dhe kërkimit shkencor përfshijnë të drejtën civile dhe tregtare, instrumentet financiare, të drejtën tregtare të Bashkimit Evropian, të drejtën tregtare ndërkombëtare, arbitrazhin ndërkombëtar, luftën kundër korrupsionit, gjyqësorin dhe të drejtën kushtetuese, etj.

Prof. Assoc. Dr. Jonida Rystemaj

Proposed by the Faculty of Law, University of Tirana.

Prof. Assoc. Dr. Jonida Rystemaj is a lecturer in "Corporate Law" and "Business Law" subjects at the Department of Civil Law, Faculty of Law, University of Tirana, where she has been teaching since October 2008. She was graduated with a medal, as an excellent student from the Faculty of Law at the University of Tirana in 2007. In 2011, she completed a Master's degree in the "EU Business Law" program, funded by GIZ, and in 2013, she achieved her PhD focusing on financial instruments and corporate finance. In 2024, she earned the academic title of Associate Professor.

Throughout her career, Prof. Assoc. Dr. Rystemaj has conducted academic research at the University of Pittsburgh, USA, as a recipient of a scholarship granted by the U.S. Department of State (January-May 2013), and periodically at the Max Planck Institute for Comparative and International Private Law, Hamburg, Germany. In addition to her academic engagements, she has contributed to civil society causes and provided expertise to civil society organizations, the Ministry of Justice, and the Parliament of Albania on issues such as human rights, international arbitration, integrity, the fight against corruption, and European integration.

Her areas of interest and research include civil and commercial law, financial instruments, EU commercial law, international commercial law, international arbitration, the fight against corruption, the judiciary, constitutional law, and more.